

PHILIPS

Smart soundbar

PB400

Manuali i përdorimit



Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/welcome

Përmbajtja

1	E rëndësishme	2
	Ndihmë dhe mbështetje	2
	Udhëzime të rëndësishme sigurie	2
	Kujdesi për produktin	3
	Kujdesi për mjedisin	3
	Pajtueshmëria	4
2	SoundBar	4
	Pajisja kryesore	4
	Telekomanda	6
	Konektorët	7
3	Lidhja	7
	Vendosja	7
	Lidhni audion nga televizori dhe pajisje të tjera	8
4	Përdorimi i SoundBar	9
	Rregullimi i volumit	9
	Aparati MP3	9
	Luajtja në televizor	10
	Luajtja e audios nëpërmjet Bluetooth	10
	Google Voice Assistant	11
	Google Chromecast Built-in	11
	Aplikoni parametrat e fabrikës	12
5	Montimi në mur	12
6	Të dhëna për produktin	13
7	Zgjidhja e problemeve	14

I E rëndësishme

Para se ta përdorni produktin, duhet t'i lexoni dhe t'i kuptoni të gjitha udhëzimet. Nëse shkaktohet ndonjë dëmtim nga mosndjekja e udhëzimeve, garancia nuk zbatohet.

Ndihmë dhe mbështetje

Për më shumë ndihmë online, vizitoni www.philips.com/support për të:

- shkarkuar manualin e përdorimit dhe manualin e shkurtër
- parë tutorialet në video (të disponueshme vetëm për disa modele)
- gjetur përgjigje ndaj pyetjeve të bëra shpesh (FAQ)
- dërguar me email një pyetje
- biseduar me një përfaqësues asistence.

Ndiqui udhëzimet në faqen e internetit për të zgjedhur gjuhën tuaj, dhe pastaj vendosni numrin e modelit të produktit.

Ose ndryshe, mund të kontaktoni numrin e kujdesit ndaj klientit në vendin tuaj. Para se të kontaktoni, shënoni numrin e modelit dhe numrin e serisë së produktit tuaj. Mund t'i gjeni këto informacione mbrapa ose poshtë produktit.

Udhëzime të rëndësishme sigurie

- Lexojini këto udhëzime.
- Ruajini këto udhëzime.
- Përmbyajini të gjitha paralajmërimeve.
- Ndiqini të gjitha udhëzimet.
- Mos e përdorni pajisjen pranë ujit.
- Pastrojeni vetëm me leckë të thatë.
- Mos i bllokoni asnjë prej hapësirave të ajrimit. Instalojeni në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.
- Mos e instaloni pranë burimeve të nxehtësisë, si për shembull pranë radiatorëve, grilave të nxehtësisë, sobave, ose pajisjeve të tjera (duke përfshirë

amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi.

- **Mos e shpërfillni qëllimin** e sigurisë që ka spina e polarizuar ose me tokëzim. Spina e polarizuar ka dy fletë. Njëra është më e gjerë se tjetra. Spina me tokëzim e tipit A ka dy fletë dhe një kunj të tretë për tokëzim. Fleta e gjerë ose kunja e tretë është për arsye sigurie. Nëse spina e dhënë nuk futet në prizën tuaj, konsultohuni me një elektrikist për ta ndërruar prizën.
- **Mos lejoni që kordoni i energjisë** të shkelet ose të kafshohet nga objektet, sidomos te spinat, prizat, dhe në pikën ku dalin nga pajisja.
- **Përdorni vetëm pjesë/aksesorë** të specifikuar nga prodhuesi.
- **Përdoreni vetëm me karrocën**, stendën, tripodin, kllapën ose tabelën e specifikuar nga prodhuesi ose që shitet me pajisjen. Kur përdoret një karrocë, bëni kujdes kur e lëvizni kombinimin karrocë/pajisje në mënyrë që të shmangni dëmtimet ose rrëzimet.
- **Shkëputeni këtë pajisje** gjatë stuhive me vetëtimat ose kur nuk përdoret për periudha të gjata.



- **Të gjitha punët e shërbimeve** duhet të bëhen nga personeli i kualifikuar i shërbimeve. Shërbimet janë të nevojshme kur kjo pajisje është dëmtuar në ndonjë mënyrë, si për shembull kur është dëmtuar kordoni ose spina e energjisë, kur janë derdhur lëngje ose kur në pajisje kanë rënë objekte, kur pajisja është ekspozuar ndaj shiut ose lagështisë, kur nuk punon normalisht, ose kur është rrëzuar.
- **KUJDES lidhur me përdorimin e baterisë**
 - Për të parandaluar rrjedhjet e baterisë, gjë e cila mund të rezultojë në lëndime trupore, dëmtime të pronës, ose dëmtime të njësisë:
 - Instalojini **të gjitha** bateritë si duhet, + dhe - siç është shënuar në pajisje.
 - Mos i përzieni bateritë (**të vjetra dhe të reja** ose karbon dhe alkaline, etj.).
 - Hiqini bateritë kur pajisja nuk përdoret për kohë të gjatë.
 - Bateritë nuk duhet të ekspozohen

ndaj nxehtësisë së tepërt, si për shembull ndaj dritës së diellit, zjarrit ose elementeve të ngjashme.

- Material perklorati - mund të kërkohet trajtim i veçantë. Shikoni www.dtsc.ca.gov/hazardouswaste/perchlorate.
- Produkti, telekomanda mund të ketë një bateri në formë monedhe/kopse e cila mund të gëlltitet padashur. Mbajeni gjithnjë baterinë larg fëmijëve! Nëse gëlltitet, bateria mund të shkaktojë dëmtime serioze ose vdekje. Mund të ndodhin djegie të rënda të brendshme brenda dy orësh pas gëlltimit.
- Nëse dyshoni se është gëlltitur ndonjë bateri ose është futur në ndonjë pjesë të trupit, kërkoni menjëherë ndihmën e mjekut.
- Kur i ndërroni bateritë, mbajini gjithnjë bateritë e reja dhe ato të përdorura larg fëmijëve. Sigurohuni që vendi i baterive është komplet i sigurt pasi ta vendosni baterinë.
- Nëse vendi i baterive nuk mund të sigurohet mirë, mos e përdorni më produktin. Mbajeni larg fëmijëve dhe kontaktoni prodhuesin.
- **Pajisja nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.**
- **Mos vendosni asnjë burim rreziku pranë pajisjes** (për shembull, objekte të mbushura me lëngje, qirinjtë të ndezur).
- Kjo pajisje mund të përmbajë plumb dhe merkur. Hidheni sipas, ligjeve shtetërore ose federale. Për informacione lidhur me hedhjen ose riciklimin, ju lutemi kontaktoni autoritetet lokale. Për më shumë ndihmë lidhur me mundësitë për riciklim, ju lutemi kontaktoni www.mygreenelectronics.com ose www.eiae.org ose www.recycle.philips.com.
- Në rastet kur përdoret spina e ENERGJISË ose një bashkues i pajisjes si pajisje për shkëputje nga energjia, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në vend që arrihet me lehtësi.
- Mos e vendosni pajisjen mbi mobilie që mund të anohen nga një fëmijë ose nga një i rritur që mbështetet, e tërheq, qëndron ose hip sipër saj. Nëse pajisja rrëzohet, ajo mund të shkaktojë lëndime serioze, ose madje vdekje.

- Kjo pajisje nuk duhet të vendoset në një vend të mbyllur si për shembull në një dollap librash ose në raft, përveçse nëse ka ajrim të mjaftueshëm. Sigurohuni që të lini rreth 20 cm ose më shumë hapësirë anembanë pajisjes.

Simboli i pajisjes Class II



Ky simbol tregon se pajisja ka sistem izolimi të dyfishtë.

Njihuni me këto simbole sigurie



Ky shenjë rrufeje tregon se materiali i paizoluar brenda pajisjes mund të shkaktojë goditje elektrike. Për sigurinë e të gjithëve në familjen tuaj, ju lutemi mos e hiqni mbulesën e produktit.



Pikëçuditja tërheq vëmendjen ndaj veçorive për të cilat duhet të lexoni me kujdes literaturën e bashkëngjitur për të parandaluar problemet me përdorimin dhe mirëmbajtjen.

PARALAJMËRIM: Për të pakësuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështisë, mbi këtë pajisje nuk duhet të vendosen objekte të mbushura me lëngje, të tilla si vazot.

KUJDES: Për të parandaluar goditjet elektrike, puthiteni fletën gjerë me vrimën e gjerë, dhe futeni plotësisht.

Kujdesi për produktin

Përdorni vetëm leckë me mikrofibra për ta pastruar produktin.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit të vjetër dhe baterisë



Produkti është ndërtuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol në një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga direktiva evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga direktiva evropiane 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike, dhe baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve dhe baterive të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimësh, shikoni pjesën lidhur me instalimin e baterive.

Pajtueshmëria


Ky produkt i përmbahet kërkesave për interferencat radio të komunitetit evropian. Këtu, MMD Hong Kong Holding Limited deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.p4c.philips.com.

2 SoundBar

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga ndihma që ofron Philips, regjistroni SoundBar në www.philips.com/welcome.

Pajisja kryesore

Në këtë pjesë gjendet një përmbledhje për pajisjen kryesore.



- ① Ndizeni SoundBar ose kalojeni në gjendje pritjeje.
- ② **(SOURCE)**
Zgjidhni një burim hyrjeje për SoundBar.
- ③ **Volume+/-**
Rritni ose ulni volumn.
- ④ Shtypni butonin për aktivizimin/çaktivizimin e mikrofonit.
- ⑤ **Mikrofoni**
- ⑥ **Treguesi LED SoundBar**
POWER ON:
 - Herën e parë, shfaq treguesin LED të burimit standard të hyrjes, më pas, shkon në statusin e fundit, p.sh. burimi i hyrjes, treguesi LED, niveli i volumnit dhe mikrofoni i heshtur ose jo i heshtur (Shënime: nëse nuk ndodh asnjë veprim për 3 min, treguesi LED i burimit do të fiket automatikisht).
 - Në pritje: Treguesi LED i fikur
 - Kur LED fiket pasi nuk është bërë asnjë

veprim për 3 minuta, shtypni çfarëdo butoni në telekomandë dhe SoundBar, përveç butonit të energjisë, për të treguar statusin e burimit.

STATUSI I BLUETOOTH:

- Modaliteti i çiftimit: drita LED blu pulson shpejt
- E lidhur: blu solide
- Shkëput: drita LED blu pulson ngadalë

STATUSI I HESHTJES SË MIKROFONIT:

- Mikrofoli i heshtur: 4 RGB portokalli

STATUSI I HYRJES AUX:

- HYRJA AUX/Hyrja audio: Jeshile solide

STATUSI I HYRJES OPTIKE:

- HYRJA OPTIKE : E kuqe solide

STATUSI I HYRJES KOAKSIALE:

- HYRJA KOAKSIALE : Lela solide

Heshtja e volumnit:


- Shtypni butonin e heshtjes së volumnit në telekomandë, LED aktual ndryshon në ngjyrë të bardhë (mbajeni heshtur kur kaloni në një burim tjetër). Shtypni përsëri butonin e heshtjes së volumnit, LED kalon përsëri në LED të burimit aktual.

AKTIVIZUESI I GOOGLE ASSISTANT:

- Përshpejtimi i sistemit: 4 LED RGB tregojnë ngjyrë të bardhë me frymëmarrje të ngadaltë.
- Rikonfigurimi standard i fabrikës: 4 LED RGB qëndrojnë konstante të bardha me zbehje në 0,5s.
- Duke pritur aktivizuesin hotword: 4 LED RGB fikur.
- Fjala e aktivizimit: shikoni animacionet e UX Google Assistant.
- Gjatë komandës së zërit: shikoni animacionet e UX Google Assistant.
- Rezultati i procesit të komandës së zërit; shikoni animacionet e UX Google Assistant.
- Dhënia e rezultatit të komandës së zërit: shikoni animacionet e UX Google Assistant.

- Koha e mbarimit të komandës: 4 LED RGB frymëmarrje e shpejtë 3 herë
- Përditësimi i firmuerit: 4 LED RGB tregojnë të gjitha frymëmarrje të ngadaltë të bardhë.
- Arritja e volumnit maksimal: 4 RGB tregojnë të gjitha pulsime të shpejtë dy herë.


Telekomanda



1. Butoni
E **ndez** dhe e **fik** pajisjen.
2. Push to Talk
Shtypni për të aktivizuar funksionin Push to Talk.
3. Butoni
Lidhja e Bluetooth
4. Butoni **VOL +**
Rritja e volumit.
5. **◀ / ▶** / **▶▶**
Shtypni shkurtimisht për të kontrolluar luajtjen e muzikës: mbrapa, kënga, pauzë / luaj, kënga tjetër.
6. Butoni **VOL -**
Ulja e volumit.
7. Butoni
Shtypni për të ndaluar luajtjen e muzikës.
8. Butoni
Hesht pajisjen ose rikthen zërin.
9. Butoni **AUX**
Kaloni në modalitetin **AUX**.
10. Butoni **OPTICAL**
Kaloni në modalitetin **OPTICAL**.
11. Butoni **COAXIAL**
Kaloni në modalitetin **COAXIAL**.

Konektorët

Kjo pjesë ka një përmbledhje të konektorëve që ka SoundBar.



① COAXIAL

Lidhni një dalje audio COAXIAL me televizorin ose pajisjen dixhitale.

② OPTICAL

Lidhni një dalje optike audio me televizorin ose një pajisje dixhitale.

③ AUX

Hyrja analoge e audios, për shembull, një aparat MP3 (stereo 3,5 mm).

④ DC IN

Lidhni SoundBar me energjinë.

3 Lidhja

Kjo pjesë ju ndihmon ta lidhni SoundBar me një televizor dhe pajisje të tjera.

Për më shumë informacion për lidhjet bazë të SoundBar dhe aksesorëve, shikoni udhëzuesin e shkurtër.




Shënim

- Për identifikimin dhe vlerat e furnizimit, shikoni etiketën e të dhënave mbrapa ose poshtë produktit.
- Para se të bëni ose të ndryshoni ndonjë lidhje, sigurohuni që të gjitha pajisjet të jenë shkëputur nga priza e energjisë.

Vendosja


Vendoseni SoundBar siç tregohet më poshtë.



Lidhni audion nga televizori dhe pajisje të tjera

Opsioni 1: Lidhni audion me anë të një kablli COAXIAL



Audio me cilësinë më të mirë



- I Duke përdorur një kabëll COAXIAL, lidhni konektorin **COAXIAL** në SoundBar me **COAXIAL** ose pajisjen tjetër.

Opsioni 2: Lidhni audion nëpërmjet një kablli optik dixhital


Audio me cilësinë më të mirë



- I Duke përdorur një kabëll optik, lidhni konektorin **OPTICAL** në SoundBar me konektorin **OPTICAL OUT** në televizor ose pajisjen tjetër.
 - Konektori optik dixhital mund të ketë emrin **SPDIF** ose **SPDIF OUT**.

Opsioni 3: Lidhni audion me anë të një kablli audio stereo 3,5 mm

Audio me cilësinë më të mirë



- I Duke përdorur një kabëll audio stereo 3.5mm, lidhni konektorin **AUX** në SoundBar me konektorin **AUX** në televizor ose pajisjen tjetër.

4 Përdorimi i SoundBar

Kjo pjesë ju ndihmon ta përdorni SoundBar për të luajtur audio nga pajisjet e lidhura.

Para se të filloni

- Bëni lidhjet e nevojshme që tregohen në udhëzuesin e shkurtër, ose shkarkoni manualin e përdorimit nga www.philips.com/support.
- Kalojeni SoundBar në burimin e duhur për pajisjet e tjera.

Rregullimi i volumnit

- I Shtypni **+/- (Volume)** për të rritur ose ulur nivelin e volumnit.
- Për të heshtur zërin, shtypni **⏏**.
 - Për të rikthyer zërin, shtypni **⏏** përsëri ose shtypni **+/- (Volume)**.

Statusi i nivelit të volumnit:

- 
- Një nga katër dritat LED RGB ndriçohen nga një dritë e dobët në dritë të fortë kur niveli i volumnit arrin 25% për 0,5s.
- 
- Dy nga katër dritat LED RGB ndriçohen kur niveli i volumnit arrin 50% për 0,5s, LED i parë qëndron solid, por LED i dytë vazhdon të ndriçohet nga një dritë e dobët në dritë të fortë.
- 
- Treg nga katër dritat LED RGB ndizen kur niveli i volumnit arrin 75% për 0,5s, dy dritat LED qëndrojnë solide, por drita LED e tretë ndriçohet nga një dritë e dobët në dritë të fortë.
- 
- Katër LED RGB ndriçohen kur arrihet volumni maksimal për 0,5s, 3 drita LED

qëndrojnë solide, por drita LED e katërt ndriçohet nga një dritë e dobët në të fortë.

Aparati MP3

Lidheni aparatin MP3 për të luajtur skedarët audio ose muzikë.

Çfarë ju duhet

- Një aparat MP3.
 - Një kabëll audio stereo 3,5 mm.
- 1 Duke përdorur kablalin audio stereo 3,5 mm, lidheni aparatin MP3 me konektorin **AUX** në SoundBar.
- 2 Shtypni **AUX** në telekomandë për të zgjedhur modalitetin **AUX**.
- 3 Shtypni butonat në aparatin MP3 për të zgjedhur dhe luajtur skedarë audio ose muzikë.

Kushtet e ambientit:

Temperatura e punimit 0 ~ 35°C,
Lagështia e punimit 65+/-20%RH

Frekuenca e punimit:

BT: 2402-2480 MHz, 2,4 G

Wi-Fi: 2412-2472 MHz

5G Wi-Fi: Banda 1: 5150 MHz deri në 5250 MHz,

Banda 2: 5250-5350 MHz,

Banda 3: 5470-5725 MHz

Fuqia maksimale RF në dalje:

Bluetooth: ≤ 10 dBm, WiFi ≤ 20 dBm

Frekuenca e punimit mund të përdoret në Evropë pa kufizime.

Për bandën e frekuencave 5150-5250 MHz dhe 5250-5350 MHz, punimet në bandë frekuencash 5150-5250 MHz dhe 5250-5350 MHz lejohen vetëm brenda.

Për t'iu përmbajtur direktivave lidhur me ekspozimin RF, kjo pajisje duhet të instalohet dhe përdoret në një distancë minimale prej 20 cm mes radiatorit dhe trupit tuaj.

Luajtja në televizor


Lidheni televizorin për të luajtur skedarë audio ose muzikë.

Çfarë ju duhet

- Një televizor me konektor COAXIAL.
- Një kabëll audio COAXIAL.

1 Duke përdorur kabëll COAXIAL, lidheni televizorin me konektorin COAXIAL në SoundBar.

2 Shtypni COAXIAL në telekomandë për të zgjedhur modalitetin COAXIAL.



Luajtja e audios nëpërmjet Bluetooth

Me anë të Bluetooth, lidheni SoundBar me pajisjen Bluetooth (si për shembull një iPad, iPhone, iPod touch, telefon Android ose laptop), dhe më pas mund të dëgjoni skedarët audio në pajisje nëpërmjet bokseve të SoundBar.

Çfarë ju duhet

- Një pajisje Bluetooth që mbështet Bluetooth të profilit A2DP dhe AVRCP, dhe me Bluetooth të versionit 4.2.
- Distanca maksimale mes një SoundBar dhe një pajisjeje Bluetooth është rreth 4 metra.

1 Shtypni  në telekomandë për të bërë që SoundBar të kalojë në modalitetin **Bluetooth**.

→ Treguesi i SoundBar pulson ngjyrë blu.

2 Në pajisjen Bluetooth, ndizeni Bluetooth, kërkoni dhe zgjidhni **Philips TAPB400** për të filluar lidhjen (shikoni manualin e përdorimit të pajisjes Bluetooth se si të aktivizoni Bluetooth).

→ Gjatë lidhjes, treguesi i SoundBar pulson ngjyrë blu.

3 Prisni derisa treguesi i SoundBar që qëndrojnë në ngjyrë blu solide.

→ Nëse lidhja dështon, treguesi pulson vazhdimisht me ritëm më të ngadaltë.

4 Zgjidhni dhe luani skedarët audio ose muzikën në pajisjen tuaj Bluetooth.

- Gjatë luajtjes, nëse vjen në telefonatë, muzika ndalon.
- Nëse pajisja juaj Bluetooth mbështet profilin AVRCP, në telekomandë mund të shtypni   për të kaluar në një këngë ose të shtypni  për të ndaluar/vazhduar luajtjen.

5 Për të dalë nga Bluetooth, zgjidhni një burim tjetër.

- Kur e riktheni në modalitetin Bluetooth, lidhja e Bluetooth qëndron aktive.



Shënim

- Përcjellja e muzikës mund të ndërpritet nga pengesat mes pajisjes dhe SoundBar, si për shembull muri, kasa metalike që mbulon pajisjen, ose pajisjet e tjera pranë që punojnë në të njëjtën frekuencë.
- Nëse doni ta lidhni SoundBar me një pajisje tjetër Bluetooth, shtypni dhe mbani shtypur  në telekomandë për ta shkëputur pajisjen Bluetooth të lidhur aktualisht.

Google Voice Assistant

Thjesht filloni duke thënë "OK Google", dhe më pas bëni pyetje ose tregojini gjëra të tilla si:

"Play some jazz"

"Turn up the volume"


"Set a 13 minute timer for pizza"

"Do I need an umbrella today?"

Google Chromecast Built-in

Ndiqui tre hapat e mëposhtëm për ta përdorur këtë veçori:

1. Lidhni një telefon ose tabletë me të njëjtin rrjet Wi-Fi që është lidhur boksi duke përdorur aplikacionin Google Home.
2. Transmeton podkaste, muzikë dhe më shumë nga më shumë se 100 aplikacione me Chromecast. Shtypni butonin Cast në një aplikacion Chromecast për të luajtur.
3. Shtypni butonin Cast në një aplikacion me Chromecast për të luajtur muzikë në boks in tuaj.



Aplikoni parametrat e fabrikës

Kur boksi ndizet, mbani shtypur butonin VOL- dhe VOL+ për 15s, boksi do të fiket vetë dhe do të rivendosë parametrat standarde të fabrikës.

5 Montimi në mur




Shënim

- Montimi i papërshtatshëm në mur mund të shkaktojë aksident, lëndime ose dëmtime. Nëse keni ndonjë pyetje, kontaktoni kujdesin për klientin në vendin tuaj.
- Para se të bëni montimin në mur, sigurohuni që muri mund ta mbajë peshën e SoundBar.

Gjatësia/diametri i vidës

Në varësi të llojit të montimit në mur të SoundBar, sigurohuni që të përdorni vida me gjatësi dhe diametër të përshtatshëm.



Shikoni ilustrimin në udhëzuesin e shpejtë për të parë mënyrën si ta montoni SoundBar në mur.

- 1) Shpuni dy vrima në mur.
- 2) Fiksoni upat dhe vidat në vrima.
- 3) Vareni SoundBar në vida.

6 Të dhëna për produktin



Shënim

- Të dhënat dhe ndërtimi mund të ndryshohen pa u njoftuar.

Amplifikuesi

- Fuqia totale RMS në dalje:
30 W RMS (+/- 0,5 dB, 1%THD)
- Përgjigjia e frekuencës: 50 Hz-15 kHz /
± 3 dB
- Raporti sinjal-zhurmë:
> 65 dB (CCIR) / (me matjen A)
- Shtrembërimi harmonik total: < 1 %
- Ndjeshmëria e hyrjes:
 - LINE IN: 450 mV +/- 50 mV

Audio

- AUX IN(3,5 mm): Hyrja audio analoge
Optike: Hyrja audio dixhitale
Koaksiale: Hyrja audio koaksiale
- Frekuenca e kampionaturës:
 - MP3: 8 kHz, 11 kHz, 12 kHz, 16 kHz,
22 kHz, 24 kHz, 32 kHz, 44,1 kHz,
48 kHz,
- Bit rate konstant:
 - MP3:8 kbps - 320 kbps

Bluetooth

- Profilet Bluetooth: A2DP, AVRCP, GAVDP,
DID
- Versioni i Bluetooth: 4.2
- Banda e frekuencës/Fuqia në dalje:
2402 - 2480 MHz / ≤ 12 dBm

Pajisja kryesore

SoundBar

- Energjia: 100-240 V~, 50/60 Hz
- Konsumi i energjisë: 18 W/2 A
- Përmasat (Gje x La x The):
560 X 65 X 107mm
- Pesha: XX kg
- **Bokset e brendshme:** 2x2,25" rreze e plotë
+2xL120*W50mm radiatorë pasivë

Bateritë e telekomandës

- 2 x AAA-R03-1,5 V

Informacione për gjendjen në pritje

- Kur produkti qëndron joaktiv për 30 minuta,
ai kalon automatikisht në gjendje në pritje
rrjeti.
- Për ta çaktivizuar lidhjen e Bluetooth, shtypni
dhe mbani shtypur ***** në telekomandë.
- Për të aktivizuar lidhjen e Bluetooth,
aktivizoni lidhjen e Bluetooth në pajisje.

7 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Rrezik goditjeje elektrike. Asnjëherë mos e hiqni kasën e produktit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni produktin vetë. Nëse keni probleme me përdorimin e këtij produkti, shikoni pikat e mëposhtme para se të kërkonti shërbime. Nëse ende keni probleme, merrni ndihmë në www.philips.com/support.

Pajisja kryesore

Butonat në SoundBar nuk punojnë.

- Shkëputeni SoundBar nga energjia për pak minuta, pastaj lidheni përsëri.

Zëri

Nuk del zë nga bokset e SoundBar.

- Lidhni kabllin e audios nga SoundBar në televizor ose pajisjet e tjera.
- Rivendoseni SoundBar në parametrat e fabrikës.
- Në telekomandë, zgjidhni hyrjen e duhur të audios.
- Sigurohuni që SoundBar nuk është i heshtur.

Zëri është i shtrembëruar ose ka eko.

- Nëse luani audio nga televizori nëpërmjet SoundBar, sigurohuni që televizori është i heshtur.

Bluetooth

Një pajisje nuk mund të lidhet me SoundBar.

- Pajisja nuk mbështet profilet e pajtueshme që nevojiten për SoundBar.

- Ju nuk keni aktivizuar funksionin e Bluetooth të pajisjes. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes se si ta aktivizoni funksionin.
- Pajisja nuk është lidhur si duhet. Lidheni pajisjen si duhet. (Shikoni “Luajtja e audios nëpërmjet Bluetooth” në faqen 10)
- SoundBar është lidhur tashmë me një pajisje tjetër me Bluetooth. Shkëputeni pajisjen e lidhur, pastaj provoni përsëri.

Cilësia e luajtjes së audios nga një pajisje e lidhur me Bluetooth është e dobët.

- Marrja e sinjalit të Bluetooth është e dobët. Afrojeni pajisjen me SoundBar, ose hiqni pengesat që janë mes pajisjes dhe SoundBar.

Pajisja Bluetooth e lidhur lidhet dhe shkëputet vazhdimisht.

- Marrja e sinjalit të Bluetooth është e dobët. Afrojeni pajisjen me SoundBar, ose hiqni pengesat që janë mes pajisjes dhe SoundBar.
- Çaktivizoni funksionin e Wi-Fi në pajisjen e lidhur për të shmangur interferencat.
- Për disa pajisje me Bluetooth, lidhja e Bluetooth mund të çaktivizohet automatikisht për të kursyer energji. Kjo nuk tregon asnjë defekt të SoundBar.



Fjala e markës Bluetooth® dhe logot e saj janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet nën licencë. Markat e tjera dhe emrat e tjerë tregtarë janë të pronarëve të tyre përkatës.

Google, Google Home, Google Play, Chromecast Built-in, dhe marka e logot e tjera tregtare përkatëse janë marka tregtare të Google LLC.

Të dhënat mund të ndryshohen pa u njoftuar.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të regjistruara tregtare të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren nën licencë. Ky produkt është prodhuar nga MMD Hong Kong Holding Limited, ose nga një prej filialeve të tij, dhe shitet nën përgjegjësinë e tyre, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

